

**INSTITUTI I MJEKËSISE
LIGJORE**
Nr 2626 Prot.
Datë, më 21.03.2024

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVA
MINISTRIA E DREJTESISË / MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
INSTITUTI PER MJEKËSI NË LIGJORE
INSTITUT ZA SUDSKU MEDICINË / INSTITUTE OF FORENSIC MEDICINE
Nr/Br/No 289 /IML
Data/Datum/Date 21.03.2024
Nr/Iraq/Br/str/No pg Marrëveshje Bashkëpunimi
PRISHTINË/FIA



Instituti i Mjekësisë Ligjore në Tiranë dhe Instituti i Mjekësisë Ligjore në Prishtinë duke kuptuar plotësisht domosdoshmërinë dhe rëndësinë e rritjes së bashkëpunimit të ndërsjellë, nënshkruanë këtë:

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

në mes të

INSTITUTIT TË MJEKËSISË LIGJORE NË TIRANË

dhe

INSTITUTIT TË MJEKËSISË LIGJORE NË PRISHTINË

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje të bashkëpunimit është rritja dhe thellimi i bashkëpunimit në fushën e mjekësisë ligjore në mes të dy instituteve nënshkruese, në pajtim me fushëveprimin e tyre dhe në pajtim me legislacionin në fuqi në të dy vendet respektive.

Neni 2
Përbajtja

1. Instituti i Mjekësisë Ligjore në Tiranë dhe Instituti i Mjekësisë Ligjore në Prishtinë, përmes kësaj marrëveshje të bashkëpunimit dhe në frymën e ngritjes së kapaciteteve profesionale zotohen se do të ndërmarrin të gjitha veprimet e mundshme në mënyrë që të realizojnë aktivitetet në vijim që përfshijnë por nuk kufizohen në:

- 1.1. Trajnine dhe hulumtime të përbashkëta në mjekësi ligjore, duke përfshirë patologjinë mjeko ligjore, toksikologjinë mjeko ligjore, antropologjinë mjeko ligjore, por pa u kufizuar vetëm në këto fusha;
- 1.2. Shkëmbime profesionale dhe vizita studimore të ekspertëve mjeko ligjorë, me qëllim të shkëmbimit të eksperienave profesionale dhe përsitimit të të rejave shkencore nga kjo lëmi shkencore;
- 1.3. Mundësinë e botimit të përbashkët të një reviste shkencore periodike;
- 1.4. Takime të përbashkëta në fushën e mjekësisë ligjore në mes të këtyre dy instituteve nënshkruese të kësaj marrëveshje bashkëpunimi;
- 1.5. Takime të përbashkëta të këtyre dy instituteve me institutet dhe institucionet respektive të shteteve të rajonit dhe shteteve tjera evropiane;
- 1.6. Koordinimin e përbashkët me qëllim të përsitimit të mbështetjes financiare dhe ekspertizës nga fondet e Bashkimit Evropian si dhe mekanizmave tjerë që mbështesin mjekësinë ligjore;
- 1.7. Ofrimin e bashkëpunimit dhe koordinimit me qëllim të anëtarësimit në organizatat e specializuara për mjekësi ligjore;
- 1.8. Ofrimin e bashkëpunimit dhe koordinimit me qëllim të pjesëmarrjes në konferanca dhe takime regionale dhe ndërkombtare në fushën e mjekësisë ligjore;
- 1.9. Ofrimin e bashkëpunimit dhe ekspertizës profesionale në fushën e hartimit dhe zbatimit të legjislacionit për mjekësi ligjore në pajtim me standartet ndërkombëtare.

Neni 3 **Përgjegjësitë e palëve nënshkruese**

1. Palët nënshkruese të kësaj marrëveshje bashkëpunimi janë përgjegjëse që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme ligjore dhe procedurale për të përmbushur obligimet që rrjedhin nga nen 2 e kësaj marrëveshje bashkëpunimi.
2. Në zbatim të obligimeve nga kjo marrëveshje bashkëpunimi, palët nënshkruese koordinohen me të gjitha institucionet kompetente në kuadër të organizimit të institucioneve shtetërore të vendit.

Neni 4
Kohëzgjatja e marrëveshjes së bashkëpunimit

Kjo marrëveshje e bashkëpunimit nënshkruhet për një periudhë 2 (dy) vjeçare nga dita e nënshkrimit dhe do të jetë efektive përgjatë këtij afati, me mundësi të vazhdimit edhe për një periudhë dy (2) vjeçare pas konfirmimit me shkrim nga të dy palët nënshkruese.

Neni 5
Personat e kontaktit

1. Secila nga palët nënshkruese do të caktojnë një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, qofshin verbale apo të shkruara, si elektronike ashtu dhe të shtypura në letër.
2. Në kohën e nënshkrimit të kësaj marrëveshje të bashkëpunimit, personat e kontaktit janë si vijon:
 - Për Instituti i Mjekësisë Ligjore në Tiranë: Dr Bledar Xhemali, Drejtor i Institutit të Mjekësisë Ligjore në Tiranë, (info) <http://www.mjekesialigjore.gov.al>
 - Për Instituti i Mjekësisë Ligjore në Prishtinë: Dr Ditor Haliti, zv Drejtor i Institutit të Mjekësisë Ligjore në Prishtinë, (info) <http://www.mjekesialigjore-ks.com>
3. Personat e caktuar sipas këtij nenit do të jenë përgjegjës për saktësinë e protokolleve, proces-verbaleve, listave dhe çdo dokumenti shoqëruesh që do të dalë në zbatim të marrëveshjes.
4. Në rast të ndryshimit të njërit nga personat e caktuar sipas këtij nenit, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi do të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda 1 (një) javë kalendarike nga data e ndryshimit, me të dhënët e personit të ri të kontaktit.

Neni 6
Zgjidhja e mosmarrëveshjes

Të gjitha mosmarrëveshjet eventuale në mes të palëve nënshkruese të kësaj marrëveshje të bashkëpunimit, do të zgjidhen me fryshtë e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet palëve nënshkruese.


Neni 7
Dispozitat përfundimtare

1. Palët nënshkruese janë të obliguara që të respektojnë dispozitat e kësaj marrëveshje të bashkëpunimit gjatë tërë kohëzgjatjes së marrëveshjes së bashkëpunimit.
2. Marrëveshja e bashkëpunimit mund të ndryshohet në procedurën e njëjtë me procedurën e nënshkrimit, vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.
3. Kjo marrëveshje e bashkëpunimit hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje identike në gjuhën shqipe, prej të cilave nga 2 (dy) kopje i merr secila palë nënshkruese.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje e bashkëpunimit hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.


Dr. Bledar Xhemali



Drejtori i Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë



Dr. Ditor Haliti



zv. Drejtore i Institutit të Mjekësisë Ligjore Prishtinë



Tiranë, 21 mars 2024